

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “*Rikonstrukcion vepra ujore , faza II*”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45232400-6

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventiv dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”i ndryshuar.* Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike, argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,731,849(dy milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekë pa tvsh

3,278,219(tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) lekë me tvsh

Preventivi i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar sipas VKM Nr 216 date 13.04.2023, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2026 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c ,i ndryshuar dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Punimet me beton

1.1 Te pergjithshme

1. Standarti i materialeve dhe i cilesise se punes nuk duhet te jete inferior ndaj asaj qe kerkohet sipas rekomandimeve te : Standarteve te Posaçme Evropiane dhe Shqiptare.
2. Kontraktori duhet te informoje perfaqsesin e Autoritetit Kontaktues para se te ndermeret me çfardolloy punimi I rendesishem betoni.
3. Autoritetit Kontaktues duhet t'i sigurohen çertifikata prove.

2.2 Materialet

2.2.1 Çimentoja

Çimentoja duhet te jete ajo e tipit te zakonçem Çimento Portlandi.Çimentoja duhet te jete e re kur dergohet ne zonen e punimeve. Nese çimentoja sillet ne thase, duhet rrualtur ne depo rrezistnce ndaj ujit dhe thaset duhet te vendosen mbi stenda te thata me distance nga dysHEMEJA per te shmangur ne kete menyre demtimin apo kontaminimin per çfardolloy shkaku.

2.2.2 Perberesit

Ata duhet te jene kimikisht inerte ndaj reaksioneve alkaline, me perjashtim te rasteve kur perzjerjes se betonit do ti behen ndryshimet e duhura per te parandaluar nje reaksion te tille.Pervec rasteve kur perberesit jane te specifikuar ndryshe, nivelimi i perberesit te ashper do te behet si vijon :

- 10 mm masa max. , e niveluar, per gjithe tipat e “paster” te betonit.
- 20 mm masa max. , e niveluar, per te gjitha tippet e betonit te perforcuar ne traversa, dhe per mure dhe pllaka me nje trashesi jo me te madhe se 400 mm.
- 200 mm masa max. , e niveluar, per butobeton qe mban mure, mure te perparme, mure mbajtes bina etj.

Absorbimi i ujit per agregatet e destinuara per beton te percaktuar per mbajtjen e ujit nuk duhet ti kaloje masen 3%.

2.2.3 Uji

Uji qe do te perdoret ne beton dhe llaç duhet te meret nga burimet e ujit te pijshem.Uji qe do te perdoret per larje dhe ruajtje duhet te jete i tille qe te mos cenoje qendrueshmerine e betonit ne fazen perfundimtare apo paraqitjen e tij.

2.2.4 Perzjerjeterzjejet do te perdoren vetem kur dhe siç specifikohet ne kete document.Perzjerjet mund te jepen vetem ne sasi fikse dhe te kalibruara nepermjet nje makine mekanike, sasi te cilat me pas perziehen me uje .

2.2.5 Fortesia e betonit

Baza per te vleresuar fortesine e betonit duhet te lidhet me gortesine karakteristike, te percaktuar si fortesi e betonit pas 28 ditesh siç eshte percaktuar me ane te metodës standarte te testimit.

2.2.6 Preparati per betonin

Perzjerjet per betonin jane lende te percaktuara per tu perdorur sipas standarteve Shqiptare. Detaje te shkalles te fortesise ngjeshese jane sa vion :

(1) Perzjerje betoni te tipit M-50	-masa maksimale e agregatit 5mm -permbajtja minimale ne çimento 280g/m ³ - raporti maksimal uje i palidhur /çimento 0.8
(2) Perzjerje butobetoni- mbajtes per struktura si mure, nenklase ujrash	-masa maksimale e agregatit 200mm me sasi maksimale guresh prej 25% -permbajtje minimale ne çimento 190g/m ³ -raport maksimal uje i palidhur/çimento 0.65
(3) Perzjerje betoni M-100- Beton i holle	-masa maksimale e agregatit 10mm -permbajtja minimale ne çimento 240kg/m ³ -maximum uje i oalidhur /çimento 0.8
(4) Perzjerje betoni M-150 – Struktura betoni	-maximum size of aggregate of quarry crushed stones 20mm -permbajtja minimale ne çimento 250kg/m ³ -raporti maksimal uje i palidhu/çimento 0.65
(5) Perzjerje betoni M-200 – Struktura betoni	-masa maksimale e agregatit te gureve te shtypur mare nga gurorja 20mm -permbajtja minimale ne çimento 290kg/m ³ -permbajtja maksimale ne çimento 350kg/m ³ -raporti maksimal uje i palidhur/çimento 0.65
(6) Perzjerje beton arme M-200 – Struktura Betoni	-prembajtja minimale ne çimento 290kg/m ³ -permbajtja maksimale ne çimento 350kg/m ³ -raporti maksimal uje i palidhur/çimento 0.65 -shufra hekuri ‘T’ ose rrjete teli ne perputhje me skicat
(7) Perzjerje betoni te tipit M-250 – Struktura betoni	-maximum size of aggregate of quarry crushed stones 20mm -permbajtja minimale çimento 330kg/m ³ -permbajtja maksimale ne çimento 350kg/m ³

	-raporti maksimal uje i palidhur/çimento 0.55
(8)	
(9) Perzjerje beton arme M-300 – Struktura betoni	-maximum size of aggregate of quarry crushed stones 20mm - permbajtja minimale ne çimento 350kg/m ³ -permbajtja maksimale ne çimento 400kg/m ³ -raporti maksimal uje i palidhur/çimento 0.55 -shufra hekuri ‘T’ ose rrjete teli ne perputhje me skicat

2.2.7 Kontrolli i cilesise

Baza kryesore mbi te cilen do te behet kontrolli do te jete krahasimi i rezultateve te prorave te kubit te ngjeshjes pas 28 ditesh, perveç kur flitet per sasi te vogla punimesh betoni, fortesia e te cilave mund te nxiret ne menyre tjeter.

Kur rezultatet nu perputhen me kerkesat e mesiperme, kontraktori duhet te modifikojë sasite e perzjerjes ne menyre qe te perftohet ajo qe kerkon specifiimi.

Ne rast se kerkesat nuk arine te plotesohen ne ditën e 28-te, kontraktori do te jete pergjegjes per te mbledhur provat qe do te vertetojne vlefshmerine e elementit perkates te struktures. Kjo mund te arihet duke mbledhur kampione te struktures dhe duke i testuar ne laboraoret respektive per testimin e materialeve te miratuar nga autoriteti kontraktues.

Ne rastet kur betoni nuk perputhet me kerkesat pasi i behet testimi ne laborat, kontraktori duhet te prishe dhe te rindertoje te gjithë elementet e perkur strukture me shpenzimet e veta.

Ne menyre qe te percaktohet dhe me pas te ruhet konsistenca e betonit te perzjere qe do te perdoret per nje strukture dhe/ose seksion te caktuar punimesh, kontraktori duhet te ndermare nje test prove me perkulje ose nje prove te faktorit te konsistences ne materialet sa vijon:

- Per çdo 6m³ beton te perzjere/grumbulluar te zones te punimeve qe a dhene çdo makineri perzjerjeje ne dhomen perkatese.
- Siç e kerkon supervizori

2.3 ZBATIMI I PUNIMEVE

2.3.1 Te pergjithshme

Armaturat e betonit duhet te jene prej druri, kompesate, çelik apo çdo lloj materiali tjeter te aprovuar me pare. Tipi, cilesia e permasave, dhe fortesia e materialeve prej te cileve jane bere duhet me pare te marin

aprovimin e perfaqsesit te Autoritetit Kontraktues. Megjithate skicat e punimeve te formave, ndertimi i tyre dhe heqja jane ne pergjegjsine e kontraktorit. Strukturat mbajtese provizore do te perdoren vetem nese jane te pastra dhe te pershtatshme. Struktura te tilla qe rezultojne te deformatuara, te thyera apo difektoze duhet te hiqen nga zona e punimeve.

Format per derdhjen e betonit duhet ti permbahen linjave dhe nivelimit dhe duhet te suvatohen me llaç dhe te jene mjaftueshmerisht te forta per te shmangur vendosjen apo perkuljet mes strukturave mbajtese. Format duhet te jene te lemuara dhe pa difete ne siperfaqe. Bulonat dhe shufrat qe do te perdoren per lidhjet e brendshme duhet te vendosen ne menyre te tille qe pjesa metalike most e demtohet ur siperfaqja e betonit te ekspozohet si ne uje ashtu e ne faktoret atmosferike. Te gjitha format duhen te ndertohen ne menyre te tille qe tem und te hiqen pa perdorur çekan e pa ushtruar leva kurndrejt betonit.

Te gjitha mbylljet duhet te jene te lehta pa montime te mundshme, ne menyre qe te mos kete humbje llaçi gjate vibrimit te betonit. Kur te kerohet nga inxhinjeri, lidhjet mes mbylljeve te paneleve do te vulosen me rripa vulosjeje sfungjeri apo material tjeter te aprovuar me pare.

Per mbylljet, te cilat si rezultat i perdorimit per nje kohe te gjate apo i perkeqsimit te pergjithshem te kushteve, do te ndertohen kuti per vrime qe do te krijohen, ne menyre qe te hiqen lehtesisht pa demtuar betonin. Ato duhen te ventilohen siç duhet ne menyre qe ajri qe ka ngecur brenda te kete mundesi te dale jashte, dhe gjithashtu duhet lene mundesi per tu vulosur me pas per te shmangur humbjet e llaçit.

Para betonimit, zona ne te cilat pritet te derdhet beton, duhet te pastrohen nga material ne siperfaqe dhe nga uji.

Nuk duhen perdorur lidhje mes mbylljeve nga te cilat rezultojne dalje direkte rjedhjesh apo bira perms ndonje elementi strukturor qe eshte pjes e strukturave per mbajtjen e ujit apo qe rezulton te jete nen nivelin taban te perfunduar te ndonje strukture nuk duhen perdorur.

2.3.2 Armatura

2.3.2.1 – Armatura druri(A)

Kjo konsiston ne derdhje te formave apo kallepeve te paneleve te sharruara, te bashkuara apo materialeve te tjera te aprovuara. Difekte te vogla si pasoje e ajrit apo uji te ngelur brenda duhet te jelohen por siperfaqja duhet te jete pa boshlleqe, hulli apo defekte te tjera te medha.

Per kolonat rrethore duhen perdorur armature metali.

Per trare arkitare, mure mbajtes, mure anesore, duhet perdorur armature qe jep pasterti te siperfaqes te perfunduar.

2.3.3.2 – Toleranca

Siperfaqet e betonit ne punimet perfundimtare nuk duhet te kene parregullsit te medha aq sa mund te shihen me sy. Ne menyre qe ti permbahen mbeshjtjelljes te kerkuar te betonit per perforcim, devijime te tjera nga siperfaqet qe percaktohen ne kontrate, nuk duhet te variojne tej masave te percaktuara ne tabelen e meposhtme:

Tabele : Devijimet e lejuara ne sip. e betonit

Lloji i punimeve te brendshme	Devijim nga linja, niveli, pingulshmeria, dimensiononi apo gjatesia e prerjes te terthorte (mm)	Parregullrsi te thesuara (mm)
Forma te sharruara	10	5
Lloji tjetër	5	3

2.3.3.3 – Prerja dhe heqja e mbylljeve hermetike

Format duhet te hiqen pa demtuar betonin.

Format pozicionuar ne sip. vertikale apo forma qe nuk mbeshtesin betonin ne perkulje nu duhet te hiqen deri kur betoni te jete aq i forte sa te perballoje forcen qe do te ushtroje era mbi beton ne momentin e heqjes te strukturave.Format qe mbeshtesin betonin ne perkulje nuk duhet te hiqen derikur:

Fortesia e betonit (siç konfirmohet nga provat kubik zhvilluar nen kushte tipike) te kete aritur 10 N/mm²; ose dy here tensionin te cilit do t'i nenshtrohet me pas betoni, cilido qofte me i madh, ose :

Specifikime Teknike	Pjesa B	Seksioni2-Punime ne betone dhe murature			Faqja 4 nga 9
---------------------	---------	---	--	--	---------------

Tabela : Periudha per prerjen e formave

Tipim i formave	Periudha e llogaritur per temp. te egra Ambient(t) midis 5 dhe 250C
Format e strukturave te meposhtme per pllaka dhe binare.	100 + (t+10)dite
Mbeshtetese per pllaka dhe binare	250 + (t+10) dite

2.4 Derdhja e betonit

2.4.1 Te pergjithshme

Para derdhjes te betonit duhet te hiqet tere uji nga hendeket.Grimca dhe papasterti te tjera duhet te hiqen, me uje dhe/ose me thithje.

2.4.2 Derdhja e mases

Betoni duhet te hidhet ne forma menjehere pas perzierjes. Ne asnje menyre nuk duhet te perdoret per betonin ajo mase qe nuk derdhet ne forma brenda 30 min. pasi del nga betonierja, me perjashtim te rasteve kur transportohet ne perzjeres teposatshem qe funksionojne ne menyre te vazhdueshme. Neraste te tilla, intervali ohor duhet te jete ai brenda 2 oreve qe nga hedhja e çimentos ne perzjerje dhe ai i brenda 30 min. qe nga derdhja nga betonierja.

Metoda dhe menyra e vendosjes te betonit duhet te jete e tille qe te shmange mundesin e veçimit te materialeve te betonit apo zhvendosjen e perforcimit.

Nuk lejohet derdhja e betonit nga nje distance prej me shume se 2.0 m apo depozitim in je sasje te madhe ne nje pike te caktuar apo zhvendosja apo punimi i tij per gjate formave.

Vendosja e betonit duhet te regullohet ne menyre te tille qe presioni i ushtruar nga betoni i lagur te mos kaloje limitet e percaktuara ne skicimin e formave.

E gjithë masa e betonit duhet te depozitohet ne shtresa pothuajse horizontale çdo pjese e forms duhet te mbushet duke e vendosur masen e betonit sa me afer pozicionit te saj perfundimtar. Agregati i forte duhet te punohet qe nga pamja ballore dhe betoni te derdhet perreth shtojcave, duke i pajisur shufrat me tuba dhe duke i forcuar pa i demtuar.

I gjithë betoni duhet te konsolidohet me pune te vazhdueshme me mjetet e duhura dhe gjithashtu me ane te mjeteve vibruese mekanike te aprovuara.

Vibratoret mekanike duhet ti perkasin nje tipi te aprovuar i cili trasmeton vibrime drejt per se drejti ne beton me intesitet te mjaftushem per te rregulluar rrjedhjen dhe pozicionin. Operimi i tyre duhet te kontrollohet me kujdes ne menyre qe te zgjase sa duhet per te aritur ngjeshjen pa trazuar me tej gje qe do te shkaktonte veçimin e mineraleve. Duhen mare te gjitha masar qe betoni te dale solid, i ngjeshur, rezistent ndaj ujit dhe i lemuar per te shmangur formimin e boshlleqeve.

Nese betonimi nderpritet per ndonje arsye per nje kohe te mjaftueshmerisht te gjate per te beret e mundur llidhjen ne te fohte(30 min) me pas ky proces duhet te nderpritet per te dhene nje lidhje kompakte, ne forme katrore, me miratimin e supervizorit, ne ate pike ku duhet nderprere betoni.

Specifikime Teknike	Pjesa B	Seksioni2-Punime ne betone dhe murature			Faqja 5 nga 9
------------------------	---------	--	--	--	---------------

Çdo betonim i cili pergatitet pa bllokuar procesin ne fjale, duke dhene keshtu nje cilesi te ulet ngjeshje do te prishte para vazhdimit te derdhjes te betonit.

2.4.3 Betonimi ne kohe te nxehte (per temp. mbi +20oC)

Nuk do te lejohet betonimi nqs temp e tij ne derdhje eshte mbi + 38 oC.

2.4.4 Betonimi ne kohe te lagesht

Betonimi ne periudha shiu te vazhdueshme nu do te lejohet me prejashtim te rasteve kur rezervat e agreeateve, paisjet perzjerse dhe transportuese, si dhe zonat qe do te betonohen jane mbuluar siç duhet.

Gjate kohes me shi kontraktori duhet te sigurohet qe pun ate perfundoje menjehere me ane te bllokimit dhe rrifillimit te proçeseve. Duhet qe te sigurohet mbulimi i mjaftueshem per te mbrojtur betonin e sapoderdhur nga shiu.

2.4.5 Betonimi ne kohe te ftohte

Nuk duhet kryher betonim ne temp. ambjenti nen +2°C.

2.4.6 Mbrojtja dhe kujdesi

Duhet ti kushtohet vemendje e duhur kujdesit dhe mbrojtjes se betonit ne te gjitha strukturat. Punimet duhet te mbrohen nga elementet, rjedhja e ujit dhe nga zhgaravitjet te çfardolloy natyre gjate punimeve te ndertimit.

Pas vendosjes dhe perfundimit te betonit per te duhet treguar kujdes.

Duhet te mbrohen sip. e perfunduara dhe cepat e mureve qe ndodhen atje ku nevojiten punime te metejshme apo transport.

Periudha per kujdesje do te perbehet nga numri i diteve i paraqitur ne tab e meposhtme.

Tabela : Koha e kujdesit

Kushtet e ambientit pas derdhjes	Periudha minimale e kujdesit dhe mbrojtjes (dite)	
	+5 0C to +10 0C	mbi +10 0C
Mesatar I ulet	4	3
	6	4
Mesatar I ulet	6	4
	10	7

Kur per te ruajtur betonin do te perdoret nje perzjerje e caktuar, kontraktori duhet te dije te tregoj se kjo perzjerje do tem und te mbuloje te gjithë betonin.

2.4.7 Heqja dhe zevendimi i betonit te cilesise te dobet

Me porosi te supervizorit dhe/ose sipas udhezimeve te perfaqshuesit te autoritetit kontaktues per tere kete, hiqni dhe zevendesoni çdo mase betoni ne çdo strukture, nese :

- Betoni nuk i permbahet specifikimeve ose

- gjenden ne beton material te demshme apo material qe kane mundesi te japin efekte negative ose
- geryerjet apo demtimet e siperfaqeve jane ne shkalle te gjere ; ose
- permasat e perfunduara te betonit nuk jane ne perputhje me skicat sipas tolerancave te lejuara ; ose
- qellimi eshte i gabuar ; ose
- mburoja prej çeliku nuk eshte mirembajtur; ose
- mbrojtja, duke perfshire kujdesin e treguar te betonit gjate ndertimit nuk ishte sa duhet duke dhene si rezultat deme te ndryshme ; ose
- Punimet riparuse apo masat e ndermara te kerkuara nga supervizori nuk jane kryer siç duhet ; ose
- deformime pa vend apo demtime ne punime kane ndodhur si rezulta i hermetizimit te pamjaftueshem, apo levizje te parakohshme apo ngarkim te tepruar; ose
- çdo lloj kombinimi i pikave te mesiperme ka ndodhur si rezultat i punes te cilesise te dobet

2.4.8 Tolerancat per strukturat prej betoni

Tolerancat per njesite e betonit parafabrikat do te jene si vijon :

- kollona
 - gjatesi : $\pm 10\text{mm}$
 - prerje e terthorte: $\pm 10\text{mm}$
 - lakim: $\pm 10\text{mm}$
- binare
 - gjatesi : $\pm 15\text{mm}$
 - prerje e terthorte: $\pm 10\text{mm}$
 - lakim: $\pm 10\text{mm}$
- mure
 - gjatesi, lartesi : $\pm 10\text{mm}$
 - trashesi: $\pm 5\text{mm}$

Vatrat mbeshtetese dhe ripat lidhes duhet te jen te pakten 6 mm te trashe.

SPECIFIKIMI I ÇMIMEVE

Germim dheu seksion i detyruar

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ germim dhe sistemim dheu ne argjinature panvaresisht nga kategoria e tokes ose menyra e realizimit te tij me mjete te mekanizuar dhe shkarkim ne mjet ose ne toke. Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor.

Beton C – 16 / 20

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ beton C – 16 / 20 per ndertimin e kanalit te betonit t=10 cm me gjeresi dhe lartesi sipas detajit teknik , duke respektuar kuotat sipas profilave gjatesor dhe terthor. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cemento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuar e betonit.

Mbushje me material gur kave

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ mbushje material gur kave pas mureve anesore te kanalit .Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialit , transportin shperndarjen e tij ne object sipas profilave gjatesor dhe terthor per te krijuar profilimin e ures sipas kushteve teknike .

Shtrese zhavori 10cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese zhavori me trashesi 10 cm pas ngjeshjes me tokmak, duke patur parasysh kuotat e kanalit , ne cmim

futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialit , transportin shperndarjen e tij ne kanal dhe ngjeshjen e tij me tokmak sipas kushteve teknike . Materiali duhet te jete zhavor ose cakell mbeturine gurore me perzjerje argjile jo me shume se 15 %.

F.V Tombino mbi shtrese betoni Ø 800m m.

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per vendosjen ne veper te 1 ml tombino ø=800 mm. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e tonbinos+ materialet e nevojshme te bendosjes se tombinos ne veper.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 ,*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP,i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2023-2024-2025 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumë prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve **2023,2024,2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për "Procedurën Tatimore "neni 64 Deklarata Tatimore.

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2026 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2026(**këstet e maturuara të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse,bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c,” Pasi cdo operator ekonomik duhet të ketë të paguara taksat dhe tarifat vendore prane njesive të qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka :

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë **pese viteve** të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit të jetë **jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin publik** Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, **vërtetime**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me **fatura tatimore** të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e

nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, osesa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1 - A (Punime germimi)
2. NP 7 - A (Ujësjetllsa,gazsjellësa,vajsjellësa,vepra kullimi dhe vaditje)
3. NS 18-A (Punime topogjeodezike)

**Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar,, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim"

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	Punime gërmimi në tokë	Punime gërmimi me eskavator	A	
NP-7	Ujësjetllsa,gazsjellësa, vajsjellësa,vepra kullimi dhe vaditje	Punime në kanal ,rikonstruktion veper ujore	A	
NS-18	(Punime topogjeodezike)	Vendosje kuotash,piketime,pjer rësia e kanaleve	A	

NP-1A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-7A (Ujësjellsa, gazsjellës, vajsjellsa, vepra kullimi dhe vaditje)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me rikonstrukion vepra ujore dhe do kryen punime në kanal është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar me këtë kategori license.

NS-18A (Punime topogjeodezike)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me rikonstrukion vepra ujore , dhe do kryehen piktimi, vendosen kuota, etj është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar me këtë kategori license,

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një Deklarate ne formularin permbledhes te veteklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

- Inxhinier Ndertimi (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Gjeodet (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, "Për Prokurimin Publik" datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" neni 39 pika 6 c.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier ndërtimi.

Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt.

Përsa I përket stafit mbështetës është kërkuar Inxhinier gjeodet në lidhje me punimet për kuotat, pjerresite, aksin e kanalit dhe vendosjen e tombinove .

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikatë trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune", e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht quhet i plotësuar edhe kur vetëm 1 operator ekonomik paraqit dokumentat për punonjesin të pajisur me certifikatë trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune".

"Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin Nr.10237 datë 10.02.2020 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", dhe ligjit nr.16/ 2014 I ndryshuar

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 11 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Manovrator** (3)

"Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë në pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

Kur mjetet janë me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, qe rast se kualifikohet i pari, do paraqese kontrate pune me manovratorin(i cili duhet te kete Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor) deri ne perfundimin e afateve te kontrates.

- **Murator** (1)
- **Karpentier** (1)

“Për punonjësit e mësipërm në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate per sigurimin teknik te punonjesve (e vlefshme);
ose
Deshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Punetore te thjeshte (4)**

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

- **Punonjës shofer kamioni (1)**

“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit autoriteti kontraktor I kerkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuar ne menyre elektronike si me poshte:

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria C
3. Certifikate Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor

Kur mjetet jane me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rast se kualifikohet i pari, do paraqese kontrate pune me shofer kamioni (i cili duhet te kete leje drejtimi kategoria C dhe Certifikate Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor) deri ne perfundimin e afateve te kontrates.

-Punonjës shofer kamioncine (1)

“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit autoriteti kontraktor I kerkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuar ne menyre elektronike si me poshte:

Kur mjetet jane ne pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria B

Kur mjetet jane me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rast se kualifikohet i pari, do paraqese kontrate pune me shofer kamioni (i cili duhet te kete leje drejtimi kategoria B) deri ne perfundimin e afateve te kontrates.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Vendosija e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka një punësim mesatar i të paktën 13 (trembedhjetë) punonjësish së bashku me stafin inxhinierik për muajin e fundit.

Kur operatori ekonomik i disponon mjetet me qira, do të paraqese **deklarate** për punonjësit (Punonjës shofer kamioncine (1), Punonjës shofer kamioni (1), Manovrator (3)), që në rast se kualifikohet i pari, të vertetojë që punonjësit janë të siguruar në Administratën Tatimore.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
Dhe
- b. Listpagesat** e konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

- . **Murator (1)**

Eshtë kërkuar 1 murator bazuar në zërat e preventivit, për struktura monolite betoni C 16/20

- **Karpentier (1)**

Eshtë kërkuar 1 karpentier bazuar në zërat e preventivit, për struktura monolite betoni C 16/20

- **Manovrator (3)**

Janë kërkuar 3 manovrator bazuar në zërat e preventivit për gërmim dheu me eskavator ,si dhe drejtimin e tokmakut,dhe fadromës

- **Punëtorë të thjeshtë (4)**

Janë kërkuar 4 puntorë të thjeshtë për punime të ndryshme sipas të gjitha zërave në preventiv.

- **Shofer kamionçine (1)**

Eshtë kërkuar 1 shofer për drejtimin e kamioncinës

- **Shofer kamioni (1)**

Eshtë kërkuar 1 shofer për drejtimin e kamionit

OBJEKTI: RIKOSTRUKSION VEPRA UJORE FAZA II

Nr.	Nr.An.	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njesia	Sasia	Op	Op gjithsej
I		REHABILITIM KANALI S.P. VRESHTAS-REZERVUARI PODGORIE				
1	3.101/a	Gërmim dhe sistemim dheu në argjinature me eks zingjir 0.5 m ³ , në kanale gjeresi der 2 m	m3	7260	0.05	363.00
2	3.352	Mbushje me gur kave	m3	130	3.40	442.00
3	2.258/2	Zhavorr nën kanal	m3	20	1.20	24.00
4	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	20	12.80	256.00
5	2.37/5b	Transport materiale ndërtimi, me auto deri 10km	m3	20	10.00	200.00
6	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	4	18.80	75.20
7	3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	ml	18	5.60	100.80
						1,461.00

- Nga zbërthimi i preventivit orët e punës për cdo zë punimi rezultojnë 1461orë
- Orët në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore $1461 : 8 = 182.63$.
kemi 183 punëtorë për një ditë pune
- 183 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 9 punëtorë për një muaj punë
- Rezulton 9 punonjes shpërndarës sipas grafikut për 1 muaj .
- **Gjithashtu duhen edhe 1 shoferë për të marrë në ngarkim kamioncinën dhe 1 shofer kamioni ,gjithsej 11 punonjës**

2.3.8 Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikata ISO ose ekuivalente te vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilesise).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2023 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëatare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Eskavator me zinxhir	2 copë	Pronësi ose me qera
2. Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
3. Tokmak për ngjeshje	1 copë	Pronësi ose me qera
4. Fadromë	1 copë	Pronësi ose me qera
5. Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
6. Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
7. Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5-7 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

(Shenim per kapacitetin mbajtes se mjeteve te kerkuara per realizimin e punimeve.Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes se qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkese te plote te lejuar ne Shqiperi dhe Mases se mjetit bosh.)

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

dhe per mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj i cili te jete i vlefshem gjate periudhes se kryerjes se punimeve.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certificate e transportit te mallrave) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit **ose** faturat tatimore te blerjes.

per mjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- aktet e zhdoganimit **ose** faturat tatimore te blerjes.

c) Deklarate nga Operatori ekonomik per makineritë e mësipërme te cilat nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata.

1- Eskavator me zinxhir 2 copë

Janë kërkuar 2 eskavator bazuar në zerat e preventivit për germim dhe ne argjinature me ekskavator zinxhir

2- Betoniere 1 copë

Është kërkuar 1 betoniere bazuar në zërin e preventivit për krijimin e betonit, ,strukturave monolite betoni

3- Tokmak për ngjeshje 1 copë

Është kërkuar 1 tokmak per ngjeshje bazuar në zerat e preventivit për ngjeshjen zhavorit nën kanal.

4- Fadromë 1 copë

Është kërkuar 1 fadromë bazuar në zerat e preventivit për të bërë mbushjen me gur kave,transportimin e zhavorit nën kanall

5- Kamion me vinc

Është kërkuar 1 kamion me vinc bazuar në zerat e preventivit per te vendosur Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni,

6- Kamioncinë kapacitet mbajtës 1.5-2 ton 1 copë

Është kërkuar 1 kamioncinë për transportin e puntorëve dhe materialeve të ndryshme si zhavor dhe gur kave për kryerjen e punimeve.

7 - Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-7 ton 1 copë

Është kërkuar nje kamion vetshkarkues për transportimin e gur kave,zhavorit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).